



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
SENATI AKADEMIK

Nr 391/15 Prot.

Tiranë, më 23.02. 2026

VENDIM  
Nr. 31 datë 23.02 2026

PËR  
MIRATIMIN E PJESËMARRJES SË EKIPEVE TË VOLEJBOLLIT  
TË UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS  
NË LOJRAT EUROPIANE UNIVERSITARE, SALERNO 2026

Mbështetur në nenin 38 të Ligjit nr. 80/2015 ‘Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë’, në nenin 20 të Statutit të Universitetit të Sporteve të Tiranës si dhe në **Vendimin e Rektoratit nr. 30 datë 16/02/2026**, Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës **23/02/2026**,

V E N D O S I:

1. Miratimin e *pjesëmarrjes së ekipeve të volejbollit (vajza + djem) të Universitetit të Sporteve të Tiranës në Lojrat Europiane Universitare 2026*, të cilat do të organizohen nga data 18 korrik 2026 deri më 1 gusht 2026 në Salerno, Itali nga Federata Europiane e Sportit Universitar.
2. Ky Vendim i përcillet Bordit të Administrimit për miratim.
3. Ky Vendim i përcillet Drejtorisë së Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore për publikim në faqen zyrtare të institucionit.
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I SENATIT

Prof.Dr. AGRON KASA

